

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

**“PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE MËNYRËN E
PËRFAQËSIMIT TË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE NË
KËSHILLIN KONSULTATIV TREPALËSH RAJONAL”**

**I.QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË
ARRIHEN**

Hartimi i këtij projektvendimi u diktua nga ndryshimi i ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me ligjin nr.136/2015, datë 5.12.2015.

Ky projektvendim synon të përcaktojë rregullat e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Konsultativ Trepalësh Rajonal (KKTR) i cili është një organ trepalësh i dialogut social në nivel rajonal.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE
DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Miratimi i projektvendimit është parashikuar si një nga angazhimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përgjegjëse për hartimin dhe ndryshimet në legjislacionin e punës në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian.

**III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË,
PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Në zbatim të nenit 200/1 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.2015, është hartuar projektvendimi për ngritjen e Këshillit Konsultativ Trepalësh Rajonal në dymbëdhjetë qarqe. Kjo nisëm synon shtrirjen e dialogut social trepalësh edhe në nivel rajonal.

Me qëllim funksionimin e KKTR, në këtë projektvendim janë parashikuar përbërja, kryesia e këtij këshilli, detyrat e kryetarit dhe nënkryetarëve, çështjet që do të konsultohen në mbledhjet e tij dhe komisionet trepalëshe të specializuara të tij.

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave”Për organizimin, funksionimin dhe mënyrën e përfaqësimit të organeve të qeverisjes vendore në KKTR”.

Në projektvendim parashikohet që Këshillat si organ konsultativ trepalësh, funksionojnë pranë Prefekturave në 12 qarqe. Ai merr vendime për çështjet që shqyrton dhe i paraqet rekomandimet përkatëse Këshillit të Qarkut ose Këshillit Bashkiak sipas kompetencës territoriale.

Efektet e pritshme janë ngritja dhe funksionimi i Këshillave në nivel rajonal me qëllim që të zhvillohen konsultime për çështje me rëndësi rajonale, në interes të palëve (Sindikatave dhe Organizatave të Punëdhënësve).

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 6 të nenit 200/1 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin 136/2015, datë 5.12.2015.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk synon përafrimin me legjislacionin e Bashkimit European.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në projektvendim parashikohet vendndodhja për funksionimin e Këshillave, përbërja e tyre, ~~çështjet që do të konsultohen, vendimet dhe rekomandimet përkatëse të cilat duhet ti dërgohen Këshillit të Qarkut dhe/ose Këshillit Bashkiak,~~ sipas kompetencës territoriale. Gjithashtu është parashikuar edhe përzgjedhja e anëtarëve përfaqësues të organizatave sindikale dhe të punëdhënësve, si dhe emërtimi i tyre i cili bëhet nga Prefekti, sipas propozimeve të vetë organizatave.

KKTR në çdo qark, mblidhet në përputhje me programin e miratuar, ose me kërkesën me shkrim të çdo pale, sipas përcaktimit të bërë në rregulloren e brendshme të funksionimit, por jo më pak se katër herë në vit.

Pranë Këshillit të çdo qarku krijohen dhe funksionojnë komisione të specializuara tripalëshe në varësi të problematikës në nivel qarku, në konsultim me partnerët socialë. Këto komisione kanë për objekt të shqyrtojnë çështje për fushat e tyre të kompetencës dhe t'i transmetojnë mendimet dhe përfundimet e këshillimeve në Këshill, lidhur me orientimin dhe zbatimin e politikave rajonale në fushat e veprimtarisë së tyre: projektaktet administrative dhe projekt marrëveshjet që kanë lidhje me fushat e veprimtarisë së tyre: çështjet për të cilat Këshilli iu është drejtuar atyre për konsultim dhe mendim.

Këshilli duhet të hartojë rregulloren e vet të brendshme mbështetur në specifikat e çdo qarku. Mënyra e organizimit dhe përgatitja e dokumentacionit të mbledhjeve të KKTR përcaktohet në rregulloren e brendshme të miratuar prej tij. Për funksionimin e Këshillit caktohet një sekretariat i përbërë nga tre nëpunës të administratës së Drejtorisë Rajonale të Punësimit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme dhe Institucioni Përgjegjës për punësimin dhe Aftësi dhe prefektët e qarqeve.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me asistencën e Zyrës Ndërkombëtare të Punës. Projektvendimi u konsultua me partnerët socialë dhe ekspertin e ILO-s në takimin e datës 15 shkurt 2017 dhe më pas ky PVKM u konsultua dhe u miratua me konsensus nga palët në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Punës të datës 17 shkurt 2017.

Ky projektvendim u dërgua për mendim në Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Brendshme.

Ministria e Drejtësisë është shprehur parimisht dakort lidhur me projektvendimin.

Ministria e Brendshme është shprehur parimisht dakort duke sqaruar se në programin “Prefektura dhe Funksionet e Deleguara të Pushtetit Vendor”, nuk janë parashikuar fonde për të mbuluar buxhetin e Këshillit Konsultativ Trepalësh Rajonal, që do të ngrihen në 12 qarqe.

Ministria e Brendshme ka shprehur mendimin se “ Shpenzimet për shpërblimin e prefektit të qarkut të përballohen nga buxheti i zyrave të punësimit në qarqe, po në vlerësimin tonë shpërblimi për vitin 2021 duhet të parashkohet në fondet e institucionit përkatës për të mbuluar shpërblimin e prefektit në qarqe.

Propozimet e Ministrisë së Brendshme lidhur me bashkëfirmosjen u morën në konsideratë nga ana jonë.

Ne reflektoam sugjerimin duke parashikuar që fondet për shpërblimin e anëtarëve të Organizatave të Punëdhënësve dhe Punëmarrësve do të përballohen nga buxheti i 12 Zyrave të Punësimit në qarqe (Institucioni Përgjegjës për Punësimin dhe Aftësi, Ministria e Financave dhe Ekonomisë) ndërsa për shpërblimin e anëtarëve për përfaqësuesit e shtetit do të përballohen nga fondet e miratuara për secilën Institucion.

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për organizimin, funksionimin dhe mënyrën e përfaqësimit të organeve të qeverisjes vendore në KKTR”.

Lidhur me shpërblimin e anëtarëve të KKTR në vlerësimin tonë ky këshill është konsultativ, i ngjashëm me Këshillin Kombëtar të Punës dhe komisionet e tij, Zyrat Shtetërore të Pajtitimit ku anëtarët e tyre shpërblehen për çdo mbledhje, në bazë të legjislacionit në fuqi.

Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë është shprehur që pika 4 e projektvendimit të riformulohet , duke parashikuar anëtarët dhe anëtarët zëvendësues, përfaqësues të organeve të qeverisjes vendore, në përbërje të Këshillit Konsultativ Trepalësh Rajonal, në përputhje me parashikimin e nenit 200/1, të Kodit të Punës.

Për këtë arsye shprehja “Kandidarë të Këshillit Konsultativ Trepalësh Rajonalë si përfaqësues të strukturave shtetërore zëvendësit përkatës “ u riformulua duke zëvendësuar me shprehjen: “Anëtarët zëvendësues marrin pjesë në seancat e Këshillit në mungesë të përfaqësuesve anëtarë”.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet finaciare janë në masën 3.600.000 lek në vit. Shpenzimet për shpërblimin e 5 anëtarëve të organizatave të punëdhënësve dhe 5 anëtarëve të punëmarrësve do të përballohen nga 12 Zyrat e Punësimit në qarqe (Ministria e Financave dhe Ekonomisë) ndërsa për shpërblimin e 5 anëtarëve për përfaqësuesit e shtetit do të përballohen nga fondet e miratuara për secilën Institucion.

PROPOZUESI

MINISTRI

SANDËR LLESHAJ



PROPOZUESI

MINISTRI

ANILA DENAJ

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave "Për organizimin, funksionimin dhe mënyrën e përfaqësimit të organeve të qeverisjes vendore në KKTR".